

Fondet ARPA të Qytetit të Uorchester

Qyteti i Uorchester ka nxjerrë një kërkesë për propozime (request for proposals, RFP) për organizatat që duan të aplikojnë për fonde nga Ligji Amerikan për Planin e Shpëtimit (American Rescue Plan Act, ARPA). Afati për propozimet është deri më 30 shtator 2022. Koalicioni për Uorchester Fantastik më të Shëndetshëm është këtu për t'ju ndihmuar.

GJENI NDIHMË DHE APLIKONI

Informacion për financimin federal të Uorchester për të ndihmuar në shëndetin publik dhe rikuperimin ekonomik

Mundësia: Qyteti i Uorchester është duke shpërndarë miliona dollarë nga qeveria federale për organizatat komunitare në vitin 2022.

Imperativi i barazisë: Këto fonde vijnë nga Ligji Amerikan për Planin e Shpëtimit (American Rescue Plan Act), ose ARPA, i cili kërkon që financimi:

- Të adresojë ndikimet e COVID-19 te komunitetet më të prekura
- Të adresojë pabarazitë e vërejtura nga këto komunitetet më të prekura

Investimi: Uorchester është duke marrë \$146.6 milionë dollarë, \$50 milionë nga të cilat i dedikohen strehimit të përballueshëm ekonomikisht dhe programeve e projekteve me bazë në komunitet.

Si mund të përfshihem?

Qyteti i Uorchester ka nxjerrë së fundi një kërkesë për propozime (request for proposals, RFP) për t'u dhënë organizatave vendore mundësinë për të aplikuar dhe për të marrë nga këto fonde ARPA.

Koalicioni për një Uorchester Fantastik më të Shëndetshëm po jep ndihmë praktike për organizatat me bazë në Uorchester për t'i ndihmuar të hartojnë dhe të paraqesin propozime, si dhe për të siguruar fonde.

Koalicioni është duke mbajtur një sërë seancash trajnimi për të ndihmuar çdo organizatë që dëshiron të aplikojë.

Gjeni ndihmë dhe aplikoni

VIZITONI FAQEN E INTERNETIT TË QYTETIT: Aplikimet duhet të paraqiten deri më datën 30.

Organizatave që aplikojnë, duhet të jenë ente ligjore dhe të regjistruara në SAM.gov në kohën e paraqitjes.

[SHKONI TE FAQA E INTERENTIT>>](#)

PLANIFIKONI NJË SESION ME PJESËMARRJE FIZIKE: Takohuni vetëm për vetëm me një instruktor **PERSONALISHT**

për t'ju ndihmuar me aplikimin tuaj.

Datat: 10 shtator, 12 shtator.

[PLANIFIKONI NJË TAKIM>>](#)

PLANIFIKONI NJË SESION VIRTUAL: Takohuni vetëm për vetëm me një instruktor **NË MËNYRË VIRTUALE** që t'ju ndihmojë me aplikimin tuaj.

[PLANIFIKONI NJË TELEFONATË VIRTUALE>>](#)

Datat: 29 gusht, 1 shtator, 7 shtator.

KONTAKTONI CHGW: Kontaktoni Koalicionin për çdo pyetje ose koment.

[DËRGONI NJË EMAIL>>](#)

Ku mund të mësoj më shumë?

Komiteti i Logjistikës Together i Uorchester ka punuar me Qytetin e Uorchester dhe ka kërkuar që kërkesat nga komuniteti dhe vendimet për financim të jenë sa më të drejta të jetë e mundur, në mënyrë që njerëzit më të prekur të kenë mundësinë të marrin pjesë dhe që çdo organizatë të ketë mundësi të aplikojë – e vogël ose e madhe qoftë ajo.

Qyteti i Uorchester ka zhvilluar sesione për të dëgjuar nevojat e komunitetit në vitin 2021 dhe ka kryer gjithashtu një studim për të informuar mënyrën se si duhet të përdoret financimi ARPA. Mund ta lexoni raportin [këtu](#).

Gjithashtu mund të shikoni një [panel](#) që tregon se si Qyteti i Uorchester i ka shpenzuar këto para federale deri më sot.

Për të mësuar më shumë rreth procesit dhe anëtarëve të komitetit, shkoni në [WorcesterMA.gov/ARPA](https://www.worcesterma.gov/arpa).

Lexoni edhe më shumë

- Mund të mësoni më shumë rreth procesit të financimit ARPA të Uorchester nga Komiteti i Logjistikës Together i Uorchester dhe Menaxheri i Qytetit të Uorchester, Eric Batista, dhe të tjerë, në veprim! Nga [poskasti](#) i Design

- Telegrami dhe Gazeta e Worcester [Agjenda e Këshillit të Qytetit: Komitete ad hoc të ARPA për të mbikëqyrur \\$50 investime për strehimin/komunitetin](#)